



K Q Z
U PROTOKOLLUA
NR. 40/4 PROT
DATE 30.11.17

AUDITUESE LIGJORE
HIDAJETE MUÇAJ
NR LIÇENCE 107, datë 21/12/2000

RAPORT I AUDITUESIT MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PËR QËLLIME TË VEÇANTA
MBI AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFTUARA DHE TË SHPENJUARA
NGA PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT vitit 2016

(Për periudhën 1 Janar 2016 – 31 Dhjetor 2016)

Shkodër, 23 Nentor 2017



RAPORT I AUDITUESIT MBI ANGAZHIMET E AUDITIMIT PËR QËLLIME TË VEÇANTA
MBI AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFTUARA DHE TË SHPENZUARA
NGA PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT viti 2016

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; me adresë : Rruga "Ibrahim Rugova" Tiranë, Albania.
Partisë "BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT", me adresë: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr.16, Tirane.

Të nderuar zotërinj!

Me vendimin nr. 196, datë 03.05.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më ka emëruar, me cilësinë e auditit ligjor, të auditoj fondet e përftuara dhe të shpenzuara për vitin 2016 prej partisë "Bashkimi Liberal Demokrat",

Opinionit

Ne kemi audituar fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga partia "Bashkimi Liberal Demokrat", për vitin 2016 të raportuara prej saj sipas kërkesave të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23, që përmban:

1. Informacion për subjektin zgjedhor, pasqyra financiare dhe deklarata;
2. Të ardhurat:
 - Të ardhura nga fondet publike
 - Të ardhura nga dhurime monetare jo-publike (private),
 - Të ardhura nga dhurime në natyrë jo-publike (private),
 - Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti zgjedhor,
1. Huatë dhe borxhet e tjera;
2. Shpenzimet

Sipas opinionit tonë, raportimet për fondet e përftuara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2016 nga partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat", paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, përputhjen me kërkesat e ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23 i tij.

Bazat e Kontabilitetit

Pa ndryshuar mendimin tonë, ne tërheqim vëmendjen se fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga Partia "Bashkimi Liberal Demokrat" janë raportuar mbi bazën e arkëtimit pagesave, për të përmbushur kërkesat e ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23 i tij. Si rezultati, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër.



Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit, SNA 800, "Auditimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrit për qëllime specifike". Përgjegjësitë tona sipas standartit janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit "Përgjegjësitë e audituesit".

Ne jemi të pavarur nga partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat", në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditim, sipas "Kodit të Etikës" për profesionistët kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (kodi BSNEPK) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e drejtimit në lidhje me raportimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të fondeve të përfuara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2016 nga partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat", në përputhje me kuadrin ligjor për financimin e partive, përcaktuar në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, kreu III i tij "Mjetet financiare dhe materiale të partive" dhe për ato kontrole të brendshme që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që të mos përmbajë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse fondet e përfuara dhe të shpenzuara nga partia " Bashkimi Liberal Demokrat", për vitin 2016 të raportuara prej saj sipas kërkesave të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo të gabimit dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto raporte financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vleresojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.



- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në raportet financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Çështje - Informacione të tjera ligjore e rregullatore

Në lidhje me auditimin e fondeve të përfuara dhe të shpenzuara nga partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat", viti 2016, ne raportojmë në vijim, çështje apo informacione të tjera ligjore e rregullatore në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe Ligjit "Për partitë politike".

1. Në lidhje me burimet e financimit të përcaktuara në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, ne raportojmë se:

Burimet e financimit të përdorura nga partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat" janë në përputhje me përcaktimin në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 17.

2. Në lidhje me shpenzimet totale që mund të kryejë një parti politike, sipas ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, ne raportojmë se :

Shpenzimet totale të kryera nga partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat" gjatë vitit 2016, janë në përputhje me përcaktimin në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23/1, pika 4 e tij, sipas të cilit: "Çdo shpenzim i kryer nga partia politike kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi", raportojmë se:

Për blerje të mallrave dhe shërbimeve, legjislacioni në fuqi dhe veçanërisht Ligji Nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", Neni 98, 99, 101 dhe 102, lejon përdorimin e Faturës me TVSH, Faturës së Thjeshtë Tatimore dhe Kuponit Tatimor për blerje jo më shumë se 40000 lekë. Nga evidenca audit e siguruar për fondet e shpenzuara gjatë vitit 2016, ne evidentoam se blerjet energjise elektrike ishin me Faturë me tvsh, dhe ky ishte kryesor i shpenzimeve që partia kishte regjistruar gjatë vitit 2016.



3. Në lidhje me publikimin e personave që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, në përputhje me përcaktimin në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23/1, pika 1 nga partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat", ne raportojmë se :

Nga evidenca audit e siguruar dhe raporti financiar i partisë politike "Bashkimi Liberal Demokrat" gjatë vitit 2016, ne nuk evidentuam persona që kishin dhuruar shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, sipas përcaktimit në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23/1, pika 1.

4. Në lidhje me dhurimin e fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, që duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike, sipas përcaktimit në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23/1, pika 2, ne raportojmë se:

Nga evidenca audit e siguruar dhe raporti financiar i i partisë politike "Bashkimi Liberal Demokrat" gjatë vitit 2016 ne nuk evidentuam persona që kishin dhuruar shuma me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, në llogari të posaçme, sipas përcaktimit në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar, neni 23/1, pika 2. Partia "Bashkimi Liberal Demokrat", ka të çelur llogari rrjedhëse në degën e Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), Tiranë, me numër AL9420511014009748LLTJCL ALLO.

5. Në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" ne raportojmë se:

Fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga partia " Bashkimi Liberal Demokrat", gjatë vitit 2016, janë regjistruar në ditar dhe në llogari si veprime dhe fakte ekonomike që i përkasin partisë politike. Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse dokumentare si fatura tatimorë. Partia politike "Bashkimi Liberal Demokrat" ka zbatuar kontabilitetin e thjeshtuar me regjistrim të njëfishtë në bazë monetare lekun, sipas kërkesave të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit (SKK Nr.15) Për mikronjësitë, bërë i detyrueshëm për zbatim nga data 01.01.2009, sipas Urdhërit nr. 94 datë 10.11.2009, të Ministrit të Financave.

Dokumenti i partisë politike "Bashkimi Liberal Demokrat", për raportimin e fondeve të përftuara e të shpenzuara gjatë vitit 2016, është plotësuar bazuar në regjistrimet e arkëtimeve e të shpenzimeve në momentin e kryerjes së tyre.

AUDITUESE LIGJORE

HIDAJETE MUÇAJ

ERSPENA E KONTABILITETIT
HIDAJETE MUÇAJ
NR. LIÇ 107 DT. 21.12.00

Shkodër, më 23 Nëntor 2017

Lagja. "Qemal Stafa", Rruga "Studenti", numër pasurije 2/988-N11, Zona Kadastrale 8591, Shkodër.

Mobile: +355 (0) 692093829;

e-mail: hydi.ekr@gmail.com; hydi_eka@yahoo.com

BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

PASQYRA E ARKETIM PAGESAVE V.2016

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Bilanci kontabel për periudhën zgjedhore mbyllur me	Shenimi nr.	Periudha
31.12.2016		
AKTIVET		
Aktive Afatshkurtera		
Aktive monetare	1	4,225
Aktive to tjera financiare afatshkurtra	2	
Totali i Aktiveve Afatshkurtera (I)		4,225
Aktive Afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	3	0
Aktivitet afatgjata jomateriale	4	
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		0
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		4,225
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrime Afatshkurtera		
Detyrime ndaj Furnitoreve	5	0
Detyrime ndaj punonjesve	6	0
Detyrime tatimore	7	0
Totali i Detyrimeve Afatshkurtera (I)		0
Detyrime Afatgjata		
Huamarrje te tjera afatgjata		
Totali i Detyrimeve Afatgjata (II)		0
Totali i Detyrimeve (I + II)		0
PASURIA NETO		
Teprica e burimeve ne fillim to periudhes	23	5,275
Rezerva e Drejtimit	24	
Teprica e burimeve te vitit financiar	22	-1,050
Totali i Pasurise neto (III)		4,225
TOTALI I DETYRIMEVE DHE PASURISE NETO (I,II,III)		4,225

Kryetari i partise

ARIAN STAROVA




BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve periudhën zgjedhore mbyllur me 31.12.2016	Shenimi nr.	Periudha
Burimet (te ardhurat) nga:		
Kuota e antarsisë	8	
Fonde publike nga shteti	9	
Dhurime nga persona fizik dhe persona juridik	10	130,696
Burime të tjera	11	0
Totali i te burimeve		130,696
Shpenzime (perdorime)		
Perdorimet per veprimtarine kryesore		
Marrje salla me qira	12	
Reklama televizive	13	
Reklama ne radio	14	
Shpenzime telefonike	15	
Shpenzime për postera, fletëvolante, fletëpalosje	16	
Shpenzime kancelarie	17	
Shpenzime për karburant	18	
Pagesa e firmave konsulente	19	
Pagesa për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	20	
KOMISIONE	21	-1,050
Energji elektrike		-130,696
Nentotali i shpenzimeve		-131,746
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore (1-2)		-1,050
Fitimet (humbjet) nga kursi i kembimi	21	
Nentotali i to ardhurave dhe shpenzimeve financiare		0
Teprica e burimeve neto e vitit financiar	22	-1,050



 Kryetari i partise
 ARJAN STAROVA



BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Pasqyra e rrjedhjes se parase (cash floë) për periudhën zgjedhore e mbyllur me 31.12.2016	Shenimi nr.	Periudha
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
Teprica e burimeve para tatimit		0
Rregullime per:		
Amortizimin		0
Rritje/renie ne tepricen e kerkesave to arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave to arketueshme to tjera		
Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve, per t'u paguar nga aktiviteti		
Mjete monetare te perfituara nga aktivitetet		0
Interesi i paguar		-1,050
Tatim mbi fitimin i paguar		-
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytezimit		-1,050
Fluksi monetar nga veprimtarite investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		0
Te ardhura nga shitja e pajisjeve		
Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetet investuese		0
Fluksi monetar nga veprimtarite financiare		
Hyrje nga huamarrje afatgjata		0
Pagesat e detyrimeve to qirase financiare		0
Mjete monetare neto e perdorur ne aktivitetet financiare		0
Rritja/renia neto e mjeteve monetare		-1,050
Mjetet monetare ne fillim to periudhes kontabel		5,275
Mjetet monetare ne fund to periudhes kontabel		4,225

B/ Kryetari i partise

ARIAN STARQVA




BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

(Te gjitha shumat jane ne leke)

Pasqyra a ndryshimeve ne pasurine neto periudhën zgjedhore mbyllur me 01.01.2016	Pasuria neto	Periudha 01.01.2016-31.12.2016
Pozicioni i mepareshem	0	0
Taprica neto per periudhen kontabel 2015	0	5,275
kalimi ne pakasim te pasurise neto	5,275	-5,275
Pozicioni me 01.01.2016	5,275	0
Teprica e burimeve per periudhen kontabel	0	4,255
Kalimi i teprices se burimeve te vitit ne pasurine neto		
Pozicioni me 31.12.2016	5,275	4,255

P/ Kryetari i partise

ARIAN STAROVA




DEKLARATË

Unë i nënshkruari Arian Starova, me nr. Karte identiteti _____ Kryetar i Bashkimit Liberal Demokrat, deklaroj se gjatë vitit 2016 kam respektuar ligjin "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe me ligjin nr.31/2015, datë 02.0.2015.

Me anë të kësaj deklarate konfirmoj para ekspertës kontabël të regjistruar në IEKA, zj. Hidajete Muçaj, e emëruar nga K.Q.Z-ja për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2016 se Bashkimi Liberal Demokrat

1. Nuk ka marrë Fonde nga buxheti i shtetit.
2. Nuk ka pasuri të lujtshme ose të paluajtshme nga të cilit të përfitojnë të ardhura në emër dhe për llogari të Partisë.
3. Dhurata në vlerë monetare janë arkëtuar 130,696 (njëqindetridhjetë mijëegjashtëqinde nëntëdhjetëegjashtë) lek, janë arkëtuar për të likuiduar shpenzimet e energjisë elektrike të selisë ku ndodhet Partia.
4. Nuk kemi marrë dhurata në natyrë ose shërbime nga persona fizik vendas të dhëna që kalojnë vlerën 1 (një) milion lek.
5. Nuk ka marrë asnjë kredi e kalojnë vlerën 1 (një) milion lek ose kundra vlefte në sende ose shërbime.
6. Zyra ku ndodhet selia e partisë është me kontratë huapërdorje.
7. Gjatë vitit 2016 nuk kemi marrë fonde nga persona juridik apo çdo aksioner i tij kur është ndodhur në kushtet që:
 - Ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncensione në dy vitet e fundit me vlerë mbi 10 (dhjetë) milion lekë.
 - Ushtron veprimtari në fushën e mediave.
 - Ka qënë partner me fonde publike në projekte të ndryshme.
 - Ka detyrime monetare ndaj Buxhetit të Shqytit ose ndaj çdo institucioni public.

p/ ARIAN STAROVA

Kryetari i Partisë BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT



DEKLARATË

Unë i nënshkruari ARIAN STAROVA, Kryetar i Bashkimit Liberal Demokrat

, deklaroj se gjatë vitit 2016 kam respektuar ligjin "Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë", miratuar me ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe me ligjin nr.31/2015, datë 02.0.2015.

Me anë të kësaj deklarate konfirmoj para ekspertës kontabël të regjistruar në IEKA, zj. Hidajete Muçaj, e emëruar nga KQZja për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2016 se Partia BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT

Ka pranë BKT-së (Bankes Kombetare Tregtare)

Llogari bankare me numer (IBAN): AL9420511014009748LLTJCL ALLO

Gjendje në vlerë leku në këtë llogari bankare me datë 31.12.2016 është 4,225 lek (katërmijëedyqindenzetepesë)

Kryetari i BASHKIMIT LIBERAL DEMOKRAT

p/ ARIAN STAROVA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIMI LIBERAL DEMIKRAT

Bulevardi "Zhan D'ARK" Nr.17 Tiranë; Cel: 0692052136

DEKLARATË

Në përgjigje të Kontratës së nënshkruar me datë 13.10.2017 midis Znj.Hidajete Muçaj, eksperte kontabel dhe z.Arian Starova-Kryetar I BLD, Neni 3 ,Pikat 3.1 dhe 3.2

Deklarojmë se:

Bashkimi Liberal Demokrat nuk disponon fonde për të paguar audituesen për kryerjen nga ana e saj të auditimit ligjor të detyrueshëm dhe të shpenzuara gjatë vgitit kalendarik 2016.

10/ KRYETARI

Arian Starova


Tiranë, më 01.11.2017